



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

Nr. 11-360/06-103102/26, më 10 JUL 2026

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet subvencionimi i qirasë për dhjetë familjet e zhvendosura nga shtëpitë e tyre, për shkak të rrëshqitjes së dheut në rrugën "A", konform konstatimit nr. 18-870/01-74833/26 të dt. 22.05.2026, të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, subvencionimi bëhet në vlerë prej 400 € (katërqind euro) në muaj dhe vlen për familjet si në vijim:
 - Familja e Hilmi Vllasaliu;
 - Familja e Dallim Tahiri;
 - Familja e Shefkat Tahiri;
 - Familj e Qazim Gashi;
 - Familja e Arben Gashi;
 - Familja e Selvete Gashi;
 - Familja e Florim Gashi;
 - Familja e Ramadan Berisha;
 - Familja e Epir Berisha;
 - Familja e Shqipe Berisha Maxhuni.
3. Subvencionimi i këtyre familjeve do të bëhet prej datës 01.06.2026 deri me datën 31.07.2026, përveçse nëse më herët se kjo datë, pushojnë se vlejtori shkaqet e këtij subvencionimi atëherë ky subvencionim mund të ndërprehet edhe më herët.
4. Të subvencionuarit si në pikën 2 të këtij Vendimi, obligohen të prezantojnë pranë drejtorive përkatëse: kontraten e qirasë, numrat e xhirollogarive bankare si dhe dokumentet identifikuese.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë dhe Drejtoria e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dërgohet:

- Të subvencionuarve;
- Drejtorisë së Financave;
- Drejtorisë së Investimeve Kapitale;
- Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

